

NEWSLETTER

Shtator



**Shtatori i Fëmijëve, apel drejtuar
Institucioneve Arsimore:
Siguroni të ardhmen e nxënësve
tuaj me Albsig.**

**Ja pse duhet te sigurohen nxënësit
dhe studentët në Albsig.**

Leter Falenderimi..!

**Shkolla “Santa Marcellina” në
Sarandë: 12 vite përkushtim për
Sigurimin e Nxënësve në Albsig**

**Albsig, 20 vite kontribut në
edukimin për sigurimin e
gjeneratave të reja**



PJESË E  KASTRATI GROUP

Shoqëria e Sigurimit Albsig sh.a., pjesë e Grupit KASTRATI, ushtron aktivitet të suksesshëm që nga viti 2004, në cilësinë e siguruesit të Jo - Jetës. Me një rrjet me 28 degë, Albsig mbulon territorin e Republikës së Shqipërisë. Albsig mbështetet në stafin e dedikuar dhe profesional dhe ofron shërbim të shpejtë dhe cilësor.

VIZIONI

Klienti, prioriteti ynë. Ne tejkalojmë pritshmëritë e tij përmes shërbimit, integritetit dhe profesionalizmit.

MISIONI

Të jemi zgjedhja e parë e çdo klienti. Ne rritemi bashkë me klientët tanë.

FILOZOFIA

Besim dhe solidaritet me klientët për të arritur suksesin e përbashkët.



Partneri juaj i sigurtë!



PJESË E  KASTRATI GROUP





Shtatori i Fëmijëve, apel drejtuar Institucioneve Arsimore: Siguroni të ardhmen e nxënësve tuaj me Albsig.

Shkolla tashmë ka filluar. Shtatori shënon fillimin e një viti të ri shkollor me emocione të reja mundësi të shumta për të mësuar e për t'u rritur. Por, ky muaj gjithashtu duhet theksuar se sjell edhe një përgjegjësi të madhe për prindërit, kjo ju bën të mundur atyre të realizojnë dhe sigurimin e mirëqenies dhe sigurisë së fëmijëve gjatë gjithë vitit të ri shkollor. Albsig, një nga kompanitë më të besueshme të sigurimeve në vend, u bën apel të gjithë prindërve që të sigurojnë fëmijët e tyre për të përfutur një vit shkollor të mbushur vetëm me suksese dhe arritje në mësim.

Një thirrje për prindërit është që në listën e blerjeve të shtohet dhe sigurimi i nxënësve dhe studenteve nga aksidentet. Kjo për shkak se jeta sa vjen e përshpejtohet, në një botë ku gjithnjë ndihemi më të pasigurtë, është më e rëndësishme se kurrë të sigurojmë një mjedis të sigurt dhe të mbrojtur për të ardhmen e fëmijëve tanë. Shkollat luajnë një rol të pazëvendësueshëm në formimin e brezit të ri dhe në ndërtimin e një të ardhmeje më të ndritur për të gjithë.

Për këtë arsye, Albsig ju fton të bëheni pjesë e iniciativës së saj për sigurimin e nxënësve duke ofruar një mburojë mbrojtëse për ata që kanë nevojë më shumë për të. Albsig është e vetmja shoqëri sigurimesh që ka bërë të mundur edukimin e konsumatorëve mbi rëndësinë e sigurimeve vullnetare pasi jo vetëm kaq por është e vetmja shoqëri sigurimesh në treg që në sigurimin vullnetar për periudhën Janar — Qershor 2024 është në vend të dytë dhe ka raportin më të lartë për sigurimet vullnetare me 57.10% ndërkohë që tregu e ka 38.76%.

Pse është i rëndësishëm sigurimi i nxënësve?

Shkolla është një vend ku fëmijët mësojnë socializohen dhe zhvillohen, por është gjithashtu edhe një mjedis ku mund të ndodhin aksidente te paparashikuara. Një lëndim gjatë orës së edukimit fizik, një incident në oborrin e shkollës apo rrugës për në shtëpi janë situata që çdo prind i ka kaluar dhe për këtë mundohet dhe dëshiron t'i shmangë sa më shumë, por që aksidentet janë të pranishme kudo dhe ato mund të ndodhin. Sigurimi i nxënësve në Albsig ofron mbrojtje financiare dhe kujdes shëndetësor për të gjitha rreziqet e kanosura. Ky sigurim nuk është vetëm një lehtësim për prindërit por është një investim për të ardhmen dhe shëndetin e sigurtë të fëmijëve tuaj në çdo hap.

Përfito sigurim dhe qetësi.

Sigurimi i nxënësve ju ofron shkollave, prindërve dhe vetë nxënësve qetësinë që vjen me dijen se ata janë të mbrojtur në çdo moment.

Përballja me rrezikun.

Aksidentet dhe fatkeqësitë janë gjithmonë të paparashikueshme. Sigurimi i nxënësve bën të mundur mbështetjen financiare në rastet kur e keqja më e madhe ju ndodh.

Mbështetje për komunitetin.

Duke ofruar sigurimin e nxënësit shkolla juaj kontribuon në ndërtimin e një komuniteti të fortë dhe të mbrojtur.

Çfarë ofron Albsig?

- **Paketa të personalizuar:** Ne ofrojmë paketa sigurimi sipas nevojave të shkollës suaj dhe kërkesave të nxënësve.
- **Shërbime të dedikuara:** Ekipi ynë profesional është gjithmonë i gatshëm të ndihmojë me çdo pyetje apo shqetësim që mund të keni.
- **Përfitime shtesë:** Me albsig shkollat përfitojnë nga ofertat e veçanta dhe mundësi bashkëpunimi për projekte të përbashkëta në mbështetje të edukimit dhe sigurisë.

Si mund të bëheni pjesë e kësaj iniciative të rëndësishme për gjeneratën e re?

Mos prisni që aksidentet të ndodhin. Kujdesuni për sigurinë e nxënësve tuaj sot dhe kontribuoni për një të ardhme të sigurtë me Albsig. **Albsig, mbrojtje e sigurtë për brezat e ardhshëm.** Bashkohuni në komunitetin e Albsig. Bëni të mundur sigurimin e nxënësve dhe studentëve tuaj. Sigurimi është i thjeshtë dhe pa komplikime. Ju ftojmë të na kontaktoni në email info@albsig.al.



Ja pse duhet të sigurohen nxënësit dhe studentët në Albsig.

Sigurimi i mirëqenies së fëmijëve si dhe sigurimi i tyre nga aksidentet të papriturat si në shkollë e jashtë saj është një ndër masat më të rëndësishme për mirëqenien e tyre. Po pse prindërit duhet të pajisin fëmijët e tyre me sigurim? Sa na mbrojnë këto sigurime? Sa siguri financiare na sjellin në buxhetin e familjeve? Këto e një sërë pyetjesh të tjera do mund t'i përgjigjemi si më poshtë. Me fillimin e vitit të ri shkollor nxënësit dhe studentët duket se janë më të ekspozuar ndaj aksidenteve në çdo hap të përditshmërisë tyre, qoftë në shkollë, në rrugë, gjatë aktiviteteve sportive apo edhe në lojëra të përditshme. Një sigurim i tillë për mbrojtjen nga aksidentet, i krijuar posaçërisht për ta, ofron mbrojtje financiare në rast të dëmtimeve që mund të ndodhin si pasojë e aksidenteve të papritura.

Sigurimi i nxënësve dhe studentëve mbrojtje financiare e buxhetit familjar.

Përditshmëria është e pasigurtë, në rast të aksidenteve të ndodhura, kostot e trajtimit mjekësor mund të jenë të larta. Një sigurim aksidenti mund të mbulojë shpenzimet për kujdesin shëndetësor të nevojshëm, duke lehtësuar kështu barrën financiare të buxhetit të familjes për shpenzimet e papritura. Në situata më serioze, kur ndodh një aksident që lë pasoja afatgjata, një sigurim i mirë për fëmijët mund të ofrojë mbështetje të mjaftueshme për të mbuluar kostot e rehabilitimit apo trajtimeve të gjata që mund të nevojiten për të siguruar rikuperimin e tyre të plotë.

Albsig jo vetëm më paketa sigurimi, por edhe me mbështetje të aktiviteteve shkollore.

Përveç fushatave edukative, Albsig numëron një numër të konsiderueshëm aktiviteteve jashtëshkollore, konkretisht aktivitete sportive, kampe verore, ekskursionet, këto evente janë pjesë e rëndësishme e zhvillimit të fëmijës, por gjithashtu mbartin dhe rreziqe. Sigurimi i fëmijëve në këto aktivitete ofron siguri të shtuar se ata janë të mbrojtur nga pasojat financiare të një aksidenti të mundshëm. Duke mundësuar sigurimin e duhur për fëmijët tuaj në Albsig ju do të ndiheni më të qetë dhe më të mbrojtur nga situatat e papritura. Kjo siguri mendore është e rëndësishme për të ditur që, në rast të ndonjë aksidenti, do të mund të përballoni situatën pa shqetësime të tepërta.

Me sigurimin në Albsig ju keni investuar në të ardhmen e fëmijës Tuaj.

Përveç mbrojtjes nga aksidentet, disa sigurime ofrojnë edhe mundësi investimi për të ardhmen e fëmijës. Duke paguar për një sigurim të tillë ju jo vetëm që mbulon rreziqet aktuale por gjithashtu kontribuoni në një të ardhme më të sigurtë për fëmijën Tuaj. Sigurimi i fëmijëve nga aksidentet e papritura nuk është thjeshtë një shpenzim, por është një investim në mbrojtjen e tyre fizike dhe financiare. Ndaj është thelbësore që të mendoni për këtë mundësi për të garantuar një mbështetje të qëndrueshme në çdo rast të paparashikuar.



ALBSIG

PJESË E  KASTRATI GROUP

Shkolla “Santa Marcellina” në Sarandë

12 vite përkushtim për Sigurimin e Nxënësve në Albsig.

Prej 12 vitesh shkolla “Santa Marcellina” në Sarandë ka qenë një shembull i shkëlqyer për kujdesin dhe sigurinë që ofron për nxënësit e shkollës së saj. Jo vetëm kaq, por drejtuesit e këtij institucioni arsimor kanë bërë të mundur edukimin e prindërve për rëndësinë e sigurimit të nxënësve. Si një institucion që i jep përparësi shëndetit dhe mirëqenies së çdo nxënësi, “Santa Marcellina” ka zgjedhur të sigurojë të gjithë nxënësit e saj me një nga kompanitë më të besueshme të sigurimeve në vend siç është Albsig, pjesë e Kastrati Group. Numëron plot 12 vite që bën të mundur sigurimin e nxënësve nga aksidentet. Jo vetëm kaq por vetëm kësaj përvoje dhe përkushtimi kanë qenë vetë prindërit e kësaj shkolle që vitet e fundit janë interesuar edhe ata vetë për sigurimin e fëmijëve.

Një histori Kujdesi dhe Sigurie vetëm përmes ALbsig.

Qysh prej fillimit të bashkëpunimit me Albsig shkolla “Santa Marcellina” ka siguruar që çdo nxënës të jetë i mbrojtur nga rreziqet e ndryshme që mund të ndodhin gjatë procesit mësimor dhe aktiviteteve jashtëshkollore. Ky përkushtim për sigurinë e fëmijëve është një tregues i rëndësishëm që shkolla i jep rëndësi mjedisit të sigurtë dhe të shëndetshëm për zhvillimin e nxënësve. “Santa Marcellina” është një institucion arsimor që e ka vlerësuar gjithmonë sigurinë dhe mbrojtjen e komunitetit saj. Në këtë kuadër, zgjedhja e një kompanie të besueshme për sigurimin e nxënësve ka qenë gjithmonë një ndër përparësitë kryesore. Për këtë arsye po shkon për më shumë se dy dekada që shkolla ka zgjedhur Albsig, një ndër kompanitë lider në tregun e sigurimeve në vend për sigurimin e fëmijëve.

Pse Albsig? Shërbim i shpejtë, i personalizuar dhe besueshmëri e plotë.

Albsig ka qenë zgjedhja e parë për shkollën “Santa Marcellina”, për shkak të reputacionit të saj si një ndër kompanitë e sigurimeve më të besuarat në tregun e sigurimeve sot në Shqipëri dhe një ndër kompanitë që dëmshpërblen në kohë rekord çdo dëm kundrejt çdo procedure të kërkuar. Jo vetëm kaq, por Albsig është e njohur për ofrimin e shërbimeve të personalizuara që përmbushin nevojat specifike të klientëve të vegjël. Shkolla “Santa Marcellina” ka përfituar nga ky focus në kujdesin ndaj klientit, duke marrë një paketë sigurimi që është krijuar posaçërisht për të mbuluar çdo rrezik të mundshëm që mund të prekë nxënësin, stafin pedagogjik gjatë dhe pas mësimi. Përkushtimi i Albsig për të ofruar shërbime të shkëlqyera ka krijuar një marrëdhënie besimi dhe sigurime që ka vazhduar dhe do të vazhdojë për dekada me radhë.





Mbrojtje e Gjithanshme. Çfarë përfshin sigurimi i nxënësve në “Santa Marcellina”?

1. Mbulim të shpenzimeve mjekësore në rast të aksidenteve që mund të ndodhin brenda dhe jashtë ambienteve shkollore. Trajtim dhe konsultim mjekësor në rast të lëndimeve dhe incidenteve të tjera.
2. Mbulim të plotë për ndërhyrje kirurgjikale dhe rehabilitim pas aksidentit.
3. Kompensim për paaftësi të përkohshme dhe të përhershme që mund të shkaktohen nga aksidentet e ndodhura brenda dhe jashtë ambienteve të shkollës.

Në ditët e sotme siguria nuk përfshin vetëm mbrojtje fizike të individëve por edhe aspektin financiar dhe ligjor. Albsig ofron një gamë të gjerë mbulimesh që përfshijnë sigurimin shëndetësor, sigurimin nga aksidentet, sigurimin e automjeteve, sigurimin e pronës si biznese dhe banesa. Kjo mbrojtje gjithëpërfshirëse i ka dhënë shkollës “Santa Marcellina” qetësinë që çdo aspekt i sigurisë tyre është mbuluar duke u mundësuar që të përqendrohen në misionin e tyre edukativ.

Përvoja dhe Espertiza.

Albsig ka një histori të gjatë në ofrimin e shërbimeve dhe produkteve të sigurimit me një ekip të përzgjedhur dhe me përvojë shumëvjeçare në këtë fushë. Kjo përvojë ka qenë një faktor kyç në suksesin e bashkëpunimit të tyre me shkollën. Përvoja dhe ekspertiza e Albsig-ut kanë garantuar që çdo incident ose problem të zgjidhet shpejt dhe me efikasitet duke minimizuar ndikimin në funksionimin e përditshëm të shkollës.

Përkushtim për Komunitetin.

Një tjetër arsye për zgjedhjen e Albsig është fleksibiliteti në krijimin e politikave të sigurimit të nxënësve dhe studentëve. Albsig, për shkollën “Santa Marcellina” ka mundur të krijojë paketa sigurimi që të mund t’i përshtatet buxhetit të shkollës dhe të prindërve të komunitetit të kësaj zone, duke mos kompromentuar në cilësinë e shërbimeve. Albsig ka ofruar gjithashtu kushte të favorshme për rinovimin e kontratave, gjë që ka ndihmuar në ruajtjen e bashkëpunimit afatgjatë. Për shkollën “Santa Marcellina”, zgjedhja e partnerëve që ndajnë të njëjtën vlerë është thelbësore. Albsig ka dëshmuar se është një kompani që kujdeset për komunitetin dhe për zhvillimin e tij. Përkushtimi i tyre për përgjegjësinë sociale ka qenë një tjetër arsye për vazhdimësinë e kësaj marrëdhënieje kaq afatgjatë dhe me shumë benefite për të dyja palët. Zgjedhja e Albsig nga shkolla është rezultat i një partneriteti të bazuar në besim, shërbime cilësore dhe përkushtim për sigurimin e fëmijëve. Ky bashkëpunim i suksesshëm dhe afatgjatë reflekton në rëndësinë që ka sigurimi në një shkollë në mënyrë të përgjegjshme dhe të qëndrueshme duke siguruar që çdo anëtar i këtij komuniteti të jetë i mbrojtur në çdo kohë.

Letër Falenderimi!

Të respektuara motra të Qendrës "Santa Marcelina",

Pranoni fjalët e mia të përzemërta për punën dhe përpjekjet tuaja në dobi të fëmijëve të Sarandës. Me qëndrimin tuaj të ndjeshëm, këshillat e mençura dhe udhëzimet e drejta, ju i ndihmoni fëmijët të kapërcejnë rrugën e vështirë të të kuptuarit të njohurive.

Është nder për mua që në emër të Shoqërisë së Sigurimeve Albsig, pjesë e Kastrati Group, t'ju drejtohem juve me respektin më të madh për kontributin që jepni në edukimin dhe mirërritjen e fëmijëve të qytetit të Sarandës.

Puna model që bëni është një shembull frymëzimi për të gjithë institucionet që merren me edukimin e fëmijëve në shkallë vendi. Bashkëpunimi që kemi me Ju për më shumë se 15 vjet na obligon t'ju shprehim konsideratën dhe gatishmërinë tonë për të qenë gjithmonë pranë jush, për të asistuar në çdo problematikë që mund të lindë dhe parashikohet në Kushtet e Kontratës së Sigurimit për çdo fëmijë dhe mësuese të kësaj shkolle.

Të jesh mësuesi i parë është gjëja më e vështirë: gjithmonë duhet të dish se ku dhe si të fillosh, si t'i interesosh të gjithë fëmijët dhe t'i vendosësh në rrugën e dijes.

Faleminderit që mund t'u jepni fëmijëve tanë dëshirën për njohuri dhe zbulime, dëshirën për të nxituar çdo ditë në shkollë dhe për të hapur faqe të reja të librit të mrekullive.

Ne ju dëshirojmë fitore të mëdha dhe suksese krijuese, forcë të jashtëzakonshme dhe lumturi të ndritshme në rrugën e jetës.

Ju dëshirojmë shëndet të mirë, energji dhe forcë, zbulime profesionale dhe nxënës të përgjegjshëm.

Respekte

Muharrem Bardhoci.

Drejtor i Përgjithshëm

Albsig.sh.a



Albsig, 20 vite kontribut në edukimin për sigurimin e gjeneratave të reja.


Prej themelimit të saj, Albsig ka qenë dhe do mbetet një ndër aktorët më të rëndësishëm në tregun e sigurimeve në Shqipëri duke luajtur një rol të madh në edukimin e brezave të rinj për rëndësinë e sigurimeve në jetë. Përgjatë këtyre 20 viteve, Albsig ka kontribuar në mënyrë të vazhdueshme për të siguruar mirëqenien e komunitetit si dhe veçanërisht të nxënësve dhe studentëve nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit të përvitshme dhe programeve edukative si pjesë e pandashme e punës në Albsig. Një nga iniciativat kryesore të Albsig ka qenë përfshirja e nxënësve në programe edukative, të cilat synojnë të ndërgjegjësojnë brezat e rinj për rëndësinë e sigurimit të shëndetit dhe të pronës. Nëpërmjet bashkëpunimeve me shkolla dhe institucione arsimore në të gjithë vendin, Albsig ka organizuar seminare dhe trajnime që u mësojnë nxënësve konceptet bazë të sigurimit, si dhe mënyrat se si sigurimet mund të mbrojnë ata dhe familjet e tyre nga të papriturat e shëndetit apo rreziqet e përditshme e të paparashikueshme.

Albsig, fushata të pandashme të Ndërgjegjësimit.

Në 20 vitet e fundit, Albsig ka lançuar një sërë fushatash të ndërgjegjësimit, të cilat kanë përfshirë materiale edukative, postera dhe video sensibilizuese. Qëllimi i këtij investimi për realizimin e herë pas hershme të këtyre fushatave ka qenë të përçojë mesazhin e rëndësisë së sigurimit dhe të nxisin një kulturë sigurie që fillon në moshën e re. Nxënësit janë njohur edhe me konceptin e “sigurimit të jetës” dhe sigurimeve të tjera që të mbrojnë nga aksidentet e papritura, dëmtimet e shumta apo rreziqet e tjera të mundshme. Jo vetëm kaq, por Albsig ka ofruar gjithashtu produkte të sigurimit të nxënësve dhe studentëve të dedikuara për ta dhe familjet e tyre. Edukimi mbi sigurimin e shëndetit të fëmijëve ka qenë një nga produktet më të suksesshme të ofruara nga kompania Albsig edhe pse në Shqipëri mungon kultura mbi sigurimin e shëndetit, duke u siguruar fëmijëve mbrojtje në rast aksidentesh apo sëmundjesh. Këto sigurime kanë lehtësuar edhe buxhetin e familjeve dhe ju kanë dhënë mundësi aksesimi në shërbimet më cilësore të rrjeteve spitalore.

Albsig, një trashëgimi e qëndrueshme e një angazhimi social.

Përveç fushatave edukative, Albsig ka qenë gjithashtu e përfshirë në projekte sociale që synojnë përmirësimin e infrastrukturës së shkollave dhe krijimin e një mjedisi më të sigurtë për nxënësit dhe studentët. Përmes donacioneve dhe investimeve në shkolla, kompania Albsig – pjesë e Kastrati Group – ka kontribuar në përmirësimin e kushteve të sigurisë dhe ka promovuar praktika të sigurta për të gjithë komunitetin shkollor. Duke shënuar 20 vjetorin e saj, Albsig është krenare për ndikimin e saj pozitiv në edukimin e nxënësve për sigurimet dhe për angazhimin e vazhdueshëm në mbrojtjen e brezave të ardhëshëm. Kjo traditë do të vazhdojë të rritet në vitet që vijnë ndërsa kompania mbetet e përkushtuar për të ofruar zgjidhje inovative dhe të sigurta për të gjithë brezat e rinj.



 +355 (0) 42254770 / 764

 info@albsig.al

WWW.ALBSIG.AL